




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-2100/14 Prot. No.
Nr. ftoje Broj. stranica 02 Nr. pages	Data Datum 10-06-2014 Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	09/06/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Xhevdet BUSHI Shef i Zyrës së Prokurimit - Komuna Hani i Elezit
CC:	z. Refki SUMA Kryetar – Komuna Hani i Elezit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Asfaltimi i rrugës Paldenicë - Dermjak”



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: “Asfaltimi i rrugës Paldenicë - Dermjak” me numër të prokurimit: KKHE-14-019-521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Asfaltimi i rrugës Paldenicë - Dermjak” me numër të prokurimit: KKHE-14-019-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna Hani i Elezit, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Asfaltimi i rrugës Paldenicë-Dermjak” me numër të prokurimit: KKHE-14-019-521. Ky aktivitet prokurimi më datë:28/05/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), pika 2.3, thuhet se Objekti i kontratës nuk është i ndarë në pjesë (lote), ndërsa tek: Paramasa dhe parallogaria e punëve në faqen 43 dhe 45 të Dosja e Tenderit janë të paraparë dy lloje, Llot 1 “Asfaltimi i rrugës Paldenicë–Dermjak” si dhe Llot 2 ”Shtirim me kubëza për rrugicat në rrugën Paldenicë-Dermjak”.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), pika III.2.4, Kapaciteti teknik dhe profesional, nën-pika 1 thuhet se: Lista e projekteve tuaja të punëve të ngjashme të realizuara në periudhën e shkuar tre vjeçare (nga viti 2010-2014) duhet të jetë minimumi në vlerë prej 1.000.000.00 €(LLOT 1). Autoriteti Kontraktues kur ka kërkuar të hyrat për vitet 2010-2014, i bie që këtu përfshihen pesë vite (2010,2011,2012,2013,2014) e jo tre vite siç është kërkuar shprehimisht me fjalë. Pos kësaj, viti aktual 2014 nuk mund të merret si dëshmi për qarkullim, pasi që viti fiskal është ende i pa përfunduar. Po ashtu vlera prej 1.000.000,00 € për lot 1 është e lartë dhe nuk është në pajtim me ligjet në fuqi. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj qarkullim financiar për tre vitet e fundit shumë të caktuar, e cila nuk duhet të kaloj dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Pika 23.6 Kriteret e përzgjedhjes që mund të përdoren nga Autoriteti Kontraktues i Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik; Neni 8 Kriteret e Përzgjedhjes i Rregullores për Prokurim Publik; si dhe Neni 5, Gjendja Ekonomike dhe Financiare i UA-02/2014.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!